



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1822/1Prot.

Tiranë, më 05 / 12 / 2019

V E N D I M

Nr. 179 , Datë 05 / 12 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, mori në shqyrtim ankesën me nr.153, datë 02.12.2019, të A. M, kundër Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak të *“përkatësisë në një grup të veçantë² dhe bindjeve politike”*.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e sjella nga subjekti ankues pranë KMD-së, citohet se ajo ka një eksperiencë pune të pandërprerë 22 vjeçare në strukturat e Policisë së Shtetit, por nuk ka bashkëlidhur ankesës ndonjë dokumentacion provues lidhur me datën e fillimit të marrëdhënieve të punës në Policinë e Shtetit. Ajo shprehet në vijim se, për punën e kryer prej saj ka marrë në mënyrë të vazhdueshme prej eprorëve dhe organizatave partnere, vlerësime maksimale dhe se gjatë

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Subjektit ankues, bazuar në Vendimin nr.18, datë 01.06.1995, të Komisionit tre palësh i është dhënë statusi i ish-të Përndjekurit Politik.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

karrierës së gjatë policore nuk ka marrë asnjë masë disiplinore për shkelje apo për mangësi gjatë ushtrimit të detyrës.

Znj.M citon se, në vitin 2013, me ardhjen në pushtet të Partisë Socialiste ajo është shantazhuar nga eprorët e emëruar rishtaz që të hiqte dorë nga gradat dhe të pranonte të punonte në një funksion të një niveli më të ulët, se përndryshe do ta largonin nga puna. Në këtë periudhë ankuesja shprehet se ka mbajtur funksionin e Shefes së Sektorit për të Miturit dhe Dhunën në Familje, në Drejtorinë për Krimet/Departamenti për Sigurinë Publike/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

Një fakt i tillë, pretendon ankuesja provohet nëpërmjet Urdhërit nr.1798, datë 04.06.2014 “Për lirim nga detyra të punonjësit të Policisë së Shtetit”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të cilin ajo e ka kundërshtuar gjyqësisht.

Ndërkaq, me Urdhërin nr.1798/1, datë 31.07.2014 “Për transferimin e punonjësit të Policisë”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, znj.M është emëruar Shefe e Sektorit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Me Urdhërin nr.220/1. Datë 08.02.2016 “Për lirim nga detyra të punonjësit të Policisë”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ankuesja është liruar për herë të dytë nga Policia e Shtetit, fakt të cilin e ka kundërshtuar sërish gjyqësisht.

Me datë 23.02.2015 me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ankuesja është emëruar pedagoge në Departamentin e Formimit Juridik/Fakulteti i Hetimit të Krimit, në Akademinë e Sigurisë.

Me Urdhër nr.220/3, datë 23.09.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, znj.M është liruar nga Policia e Shtetit, me motivacionin “Për shkurtim të funksionit organik”, veprim të cilin ajo e ka kundërshtuar gjyqësisht. Ajo shprehet se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka rrëzuar kërkesë padinë e saj, ndryshe nga ajo e kolegëve të tjerë duke e diferencuar atë në trajtimin që i kanë bërë shqyrtimit të çështjes së saj.

Subjekti ankues pretendon se është diskriminuar nga ana e Policisë së Shtetit, pasi brenda dy viteve (2014-2016) ajo është larguar tre herë nga puna, deri në lirim përfundimtar të saj nga forcat e Policisë së Shtetit, gjë që i ka shkaktuar trauma psikologjike⁴ dhe dëm ekonomik⁵.

⁴ Vërtetuar nëpërmjet dokumentit mjekësor me nr.regj.4439, datë 17.06.2014 të mjekut specialist psikiatër.

M për të faktuar shkakun për të cilin pretendon diskriminimin, përkatësinë e saj në grupin e ish-të përndjekurve politikë, shprehet se që në moshën dhjetë vjeçare⁶ ka vuajtur internimin/dëbimin politik familjar nga qyteti i Tiranës, në fshatin Dragot të zonës së Dumresë, dënim i cili ka zgjatur njëzet e tre vite. Ankuesja shprehet se shkak i këtij persekucioni ka qenë dënimi i gjyshit të saj, i cili nëpërmjet Vendimit nr.103, datë 31.05.1945 të Gjykatës Ushtarake të qytetit të Korçës ishte dënuar me vdekje/pushkatim, vendim i cili u ekzekutua nga regjimi i asaj kohe. Nëpërmjet Vendimit nr.18, datë 01.06.1995, të Komisionit tre palësh, ankueses i është dhënë statusi i ish-të Përndjekurit Politik.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar konstatimin e diskriminimit për shkak të background-it të saj politik.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Bazuar në deklaratimet dhe në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues, Komisioneri, konstaton se:

- A. M është liruar për herë të fundit nga Policia e Shtetit nëpërmjet Urdhërit nr.220/3, datë 23.09.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ka marrë dijeneri për këtë fakt. Nuk mund të shprehemi për datën e saktë të marrjes dijeneri, pasi ankuesja nuk e ka cituar shprehimisht, por bazuar në faktin që ajo e ka kundërshtuar gjyqësisht atë, ajo ka marrë dijeneri, të paktën brenda vitit 2016.
- Në kontekst të sa mësipër, **ankuesja ka marrë dijeneri për Urdhërin e lirimit nga Policia e Shtetit (për të cilin dhe pretendon diskriminimin), që në muajin shtator 2016.**

⁵ Ankuesja shprehet se është trajtuar për dy vite me pagesë kalimtare, pas lirimit nga Policia e Shtetit dhe më pas 10 muaj me pension të parakohshëm.

⁶ Qysh prej vitit 1968 deri në vitin 1991.

Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 02.12.2019, pra më vonë se tre vite nga marrja dijani.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt*”, ankesa e A. M, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ndërsa, sa i takon pretendimit të znj.M se është trajtuar në mënyrë të diferencuar nga kolegët e saj në kushte të njëjta me të, nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me vendimmarrjen e kësaj të fundit; Komisioneri informon subjektin ankues se shqyrtimi i vendimmarrjes së gjykatave nuk është kompetencë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe se ato i nënshtrohen vetëm shqyrtimit gjyqësor të shkallëve më të larta të pushtetit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së A. M, për shkak se është jashtë afatit për shqyrtimin e ankesave, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja djjeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë, bindjet politike